



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ae.nr.103/2020

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar kolegji, Liridon Maloku dhe Rustem Thaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit NTP [“A...”], me seli në Ferizaj, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [J.R.] nga Ferizaj, kundër të paditurave [“K...”] sh.a., me seli në Prishtinë, dhe “KEK” sh.a., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [R.P], për shkak të borxhit në shumën e përgjithshme prej 6,221.13€, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurve të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.nr.437/2019 të datës 21.04.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.07.2021, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**APROVOHET** ankesa e të paditurve [“K...”] sh.a., me seli në Prishtinë, dhe “KEK” sh.a., me seli në Prishtinë ndërsa **PRISHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.nr.437/2019 të datës 21.04.2020, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar e ka në piken I të dispozitivit të aktgjykimit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit NTP [“A...”], me seli në Ferizaj, kundër të paditurave [“K...”] sh.a., me seli në Prishtinë, dhe “KEK” sh.a., me seli në Prishtinë. Ndërsa në piken II të dispozitivit është obliguar e paditura e parë [“K...”], me seli në Prishtinë që mos ta kërkojë borxhin e ngarkuar me energji elektrike sipas faturës së datës 29.07.2011, me të cilën paditësi NTP [“A...”], me seli në Ferizaj është ngarkuar nga KEK-u në shumën e mjeteve 6,221.13€ në emër të rikthimit të humbjeve nga shkak i mungon legjitimiteti pasiv. Në piken III të dispozitivit është obliguar e paditura e dytë “KEK”, me seli në Prishtinë që mos ta kërkojë borxhin nga paditësja NTP [“A...”], me seli në Ferizaj, në shumën prej 6,221.13€ të faturuar më datën 29.07.2011 nga e paditura e dytë “KEK”, me seli në Prishtinë nga shkak i ketë borxh e ka zënë parashkrimi. Ndërsa në piken IV të dispozitivit është obliguar e paditura e parë [“K...”] dhe e paditura e dytë “KEK” që të bëjnë pagesën e shpenzimeve procedurale në shumën prej 1,070.00€.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura ["K..."] sh.a., me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit që ankesën ta aprovoje si të bazuar, ashtu që Aktgjykimin IV.EK.nr.437/2019, e datës 21.04.2020, t'a ndryshoje me refuzimin e kërkesëpadisë në tërësi sa i përket të paditurës së parë ["K..."] sh.a., ose të prish aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, si dhe të obligohet paditësi ti bartë shpenzimet për ankesë në lartësi sipas UA 01/2017 për taksat gjyqësorë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë edhe e paditura "KEK" sh.a., me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoje ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin IV.EK.nr.437/2019 i datës 21.04.2020 të ndryshohet me refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala paditëse NTP ["A..."], me seli në Ferizaj, me propozimin që ankesa e të autorizuarit të palës së paditur të parë dhe të dyte të refuzohen në tërësi si të pabazuar ndërsa aktgjykimi IV.EK.nr.437/2019 të datës 21.04.2020 të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 505.1 të LPK-së, gjeti se:

#### **Ankesat janë të bazuara.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh së paditësi, NTP ["A..."], me seli në Ferizaj, me datën 28.05.2018 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për vërtetim të mos ekzekutimit të borxhit, kundër të paditurave ["K..."], me seli në Prishtinë, dhe "KEK" sh.a., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësja nuk e ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizuar të borxhi në shumën prej 6,221.13 në emër të rikthimit të energjisë kinse të humbur nuk ekziston si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e palës paditëse lidhur me borxhin e ngarkuar me energji elektrike sipas faturës së datës 29.07.2011. Po ashtu ka konstatuar se është vërtetuar se të paditurës së parë Ndërmarrja ["K..."] u mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë në këtë çështje, nga fakti se ["K..."] ka filluar të funksionoj si person juridik nga data 08.05.2013 do të thotë shumë vone se sa paditëses i është faturuar borxhi në emër të rikthimit të humbjeve, çka vërtetohet me faturën e datës 29.07.2011. Ndërsa në piken II është obliguar e paditura e dytë "KEK-u", që të mos ta kërkojë borxhin nga paditësja NTP ["A..."], në shumën prej 6,211.13€ të faturuar me datën 29.07.2011 nga e paditura "KEK-u" nga shkak se këtë borxh e ka zënë parashkrimi. Prandaj, gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitat e nenit 360 par.1 dhe 2, nenit 378 të LMD-

së, si dhe nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së, e vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës.

Kontradiktoriteti i dispozitivit me arsyetimin qëndron në faktin se gjykata e shkallës së parë në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar e obligon të paditurën e parë ["K..."] që mos ta kërkojë borxhin ndërsa në arsyetim thekson se të njëjtës i mungon legjitimiteti pasiv. Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë sepse nuk mund të obligohet pala e cila nuk ka legjitimitet pasiv në çështjenjuridike. Për më tepër gjykata e shkallës së parë përkundër mungesës së legjitimitetit e ka detyruar të paditurën ["K..."] edhe për pagesën e shpenzimeve procedurale. Kjo formë e formulimit të dispozitivit dhe arsyetimit, e bën aktgjykimin kontradiktor me vetveten.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, por në mënyrë të njëanshme duke velerësuar vetëm datat e pagesave dhe datën e parashtrimit të padisë ka marrë vendimin e atakuar. Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale.

Aktgjykimi i atakuar në arsyetimin e tij nuk thekson fare se nga cilat prova cilat fakte janë vërtetuar, cilave prova ia ka falur besimin gjykata, por gjykata është mjaftuar vetëm me theksimin e provave të administruara pa dhënë fare arsyetim se cilat fakte i ka vërtetuar nga këto prova dhe duke e anashkaluar faktin thelbësor për të cilin zhvillohet kontesti. Në rastin konkret padia është ushtruar për vërtetimin e faktit se paditësja nuk e ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike prandaj borxhi kontestues nuk ekziston ndërsa gjykata e shkallës së parë pa e vërtetuar nëse është i bazuar pretendimi nga kërkesëpadia, respektivisht nëse ekziston borxhi kontestues duke e marrë si jokontestues ekzistimin e borxhit pa e vërtetuar fare, është obliguar e paditura e dytë "KEK", që mos ta kërkojë borxhin nga paditësja nga shkakun së ketë borxh e ka zënë parashkrimi.

Si pasojë e mosvërtetimit të plotë të gjendjes faktike ka ardhur edhe deri të zbatimi i gabuar i së drejtës materiale. Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar dispozitat e Nenit dhe 378 të LMD-së, por bazuar në konstatimet nga arsyetimi, mbi gjendjen faktike të konstatuar nuk është vërtetuar nëse detyrimi ka ekzistuar para se të vendosë nëse ky detyrim është parashkruar.

Gjykata e shkallës së dytë nuk mund ta pranojë këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë nga shkak se, provimi i fakteve varësisht prej llojit dhe natyrës së faktit është detyrë e palëve si dhe e gjykatës. Gjatë procedurës gjyqësore objekt i të provuarit duhet të jenë të gjitha faktet relevante të cilat janë me ndikim në vendosjen e çështjes. Gjykata ka për detyrë që gjendja faktike të vërtetohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe në këtë drejtim duhet të kujdeset që të administrohen të gjitha faktet të cilat janë thelbësore për epilogun e kontestit. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë pa e vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe i ka obliguar të paditurat që mos ta kërkoje borxhin e ngarkuar.

Mos vërtetimi i validitetit të provave kontestuese, si prova të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, përbejnë shkelje të dispozitës së Nenit 183.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare”*.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga Nenit 183.1 dhe Neni 160 par. 3 dh 4 të LPK-së, që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë dhe si rrjedhojë gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale, aplikimin e drejtë të secilës në bazë të nenit 194 të LPK, gjykata e shkallës së dytë e vlerëson sipas detyrës zyrtare, andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Në ri-procedurë gjykata e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë, në atë mënyrë që të eviton kundërthëniet ekzistuese në mes dispozitivit me arsyetimin, arsyetimit me faktet vendimtare dhe me arsyet e theksuara për çështjet kruciale dhe sipas nevojës të nxjerrë provat e nevojshme për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ta vërtetojë ekzistimin apo jo të detyrimit të ndërsjellë të palëve dhe lartësinë e detyrimit dhe pas kësaj të vendos, duke marrë vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën c) të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,**  
**Ae.nr.103/20 data 05.07.2021**

**KRYETARI I KOLEGJIT- GJYQTARI**

*Mahir Tutuli d.y.*

